



Ref.nr 450 ; Prishtinë, / 31/3/2021

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË SHËRBIME

Titulli i Kontratës: "Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës"

Nr i prokurimit 242-20-1251-2-1-1

Nr i brendshëm 90400/20/014/211

Përgatitur me datën: 01.04.2021

PALËT NË MARRËVESHJE

Universiteti i Prishtinës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
"Rojet e Nderit" Sh.p.k., 810519209 me pronar Kushtrim Krasniqi, (në kryerjen e shërbimeve), janë
pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për shërbimet e shënuar me poshtë:

"Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës"

Nr i prokurimit 242-20-1251-2-1-1

Nr i brendshëm 90400/20/014/211

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

"Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës"

Autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës –Hasan Prishtina, kërkon të bëhen shërbime vetëm në emër të Universiteti i Prishtinës –Hasan Prishtina.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 01.04.2021 dhe përfundon në datën 01.04.2024.

Neni 2

Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerjen e shërbimeve do të jetë për gjdo ditë të parapar sipas specifikimit teknik për të gjitha Njesit Kerkuese dhe sipas kërkesave me të cilat mund të paraqiten gjat 36 muaj prej ditës së nënshkrimit të Kontratës me Autoritetin Kontraktues (01.04.2021 deri 01.04.2024).

Shërbimeve do të realizohet në koordinim me mes tri palëve: Operatorit Ekonomik, Menaxherit të Kontrates dhe Mbiqkyersit të Menaxherit të Kontrates.

Neni 3

Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 2,125,837.44 Euro. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është ± 30%.

Nr	Përshkrimi	Njësia Matese	Sasia	Çmimi për Njësi pa TVSH	TVSH (%)	Çmim për Njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	"Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës"	Orë	823968	2.19	18%	2.58	2,125,837.44
TOTALI I PERGJITHSHEM ME TË GJITHA TAKSAT E APLIKUESHME NË KOSOVË DUKE PËRFSHIRË EDHE TVSH- SI DHE PAGAT E PUNTOREVE, UNIFORMAT, DHE TË TJERA SIPAS ANALIZES FINANCIARE.							2,125,837.44

Ofertuesi duhet te siguroj personel të mjaftueshëm për mirëmbajtje të objekteve gjatë 24 orëve dhe duhet të organizoj punën në atë mënyrë që shërbimet e kërkuara të realizohen pa ndërprere. Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është ±30%. Verejtje: OE duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analizë duhet të përfshijë:

- Pagat bruto per puntorë me të gjitha kontributet dhe tatimet duke perfshire edhe TVSH.
- Vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit në dosjen e tenderit.
- Pushimet vjetore, ndrrimet e natës, festat shtetërore
- Fitimi i parashikuar nga O.E.

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Totali i koston mesatare e shperndar për një puntor	Totali per 12 muaj për nje puntor	Totali për 36 muaj për nje puntor
1.	Paga bruto	280.00	3,360.00	10,080.00
2.	Orët e natës 30%	20.24	242.88	728.64
3.	Orët festive 50%	4.60	55.20	165.60
4.	Orët e vikendit 50%	39.87	478.44	1,435.32
5.	Pushimi vjetor mesatar ne muaj	21.21	254.52	763.56
6.	Gjithsejt paga bruto, oret e nates, festat, vikendet, pushimet vjetore (1+2+3+4+5)	365.92	4,391.04	13,173.12
7.	Trusti pensional 5% I punëdhënësit	18.13	219.55	658.66
8.	Uniforma Dimrore	0.33	3.96	11.88
9.	Uniforma Verore	0.20	2.40	7.20
10.	Fitimi i kompanis per nje puntor ne muaj	0.05	0.60	1.80
11.	Gjithsej Kostoja per puntor (6+7+8+9+10) pa tvsh	384.80	4,617.55	13,852.66
12.	18% TVSH-ja	69.26	831.16	2,493.48
13.	Gjithsej kostoja per puntor (11+12) me tvsh	454.06	5,448.71	16,346.13
14.	Çmimi pa TVSH per nje ore pune per nje puntore per 176 orë pune (U.AD.(MPMS) Nr.09/2017	2.19	2.19	2.19
15.	18% TVSH-ja	0.39	0.39	0.39
16.	Çmimi me TVSH per nje ore pune	2.58	2.58	2.58

Nr.	Përshkrimi	Oret Totale për 36 muaj	Çmimi për orë me tvsh	Totali për 36 Muaj
1.	Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës	823,968.00	2.58	2,125,837.44 euro

- OE nënë përgjegjësin e saj është e obliguar që të respektoj pagën bazë mujore minimale në Shumen prej 280 euro, ku duhet të parashihet shtes për pagesë sipas ligjit të punës.
 - Orë për punë gjat diteve te festive
 - Orë për punë gjat nates
 - Orë për punë gjat fundjaves
 - Orë për punë gjat pushimit vjetor
 - Oferta duhet te këtë te kalkuluar edhe çmimi e uniformave të punës (dimrore dhe verore)

Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

-Te ofrohet shërbimi i sigurimit fizik per objektet dhe hapsiren e Universitetit te Prishtines, 24 ore ne dite 7 dite te javes, vendosjen dhe monitorimin e sistemeve te mbikëqyrjes elektronike, roje statike per kontroll te hyrje-daljes se njerëzve, automjeteve dhe artikujve, patrullime përreth objekteve te UP-se, gjate dhe jashte oreve te punes, per te siguruar perimetrin e objekteve dhe hapësirave te UP-se.

-Operatori Ekonomik duhet te jete ne gjendje te kryej shërbime, duke zbatuar profesioalizem, efikasitet dhe fleksibilitet te shërbimeve.

-Operatori Ekonomik duhet te mirëmbaj ato ekzistuese dhe te implementoj zgjidhje te reja per sigurine fizike dhe teknike

-Operatori Ekonomik duhet te garantoj se personeli i tyre do te kryejne shërbime ne përputhje me përcahtimet e kontrates, ne interesin me te mire te UP-se, personelit dhe studenteve. Ne te njejten kohe, Operatori Ekonomik duhet te garantoj te gjitha ndërtesat, hapësirat dhe te mirat materiale te Up-se do te jene te sigurta dhe te mbrojtura nga vjedhja, demtimi, zjarri apo rreziqet tjera.

VERETËJE:

Kompania që të vlersohet e përgjegjeshme është e obliguar që të respektoj pagën bazë mujore minimale në shum prej 280 € bruto, duhet te parashihet shtesë për pagës sipas ligjit të punës: orë për punë gjatë ditëve të festave, orë për punë gjatë natës, orë për punë gjatë fundjavës ,orë për punë gjatë pushimit vjetor.

Oferta duhet të këtë të kalkuluar edhe çminin lidhur me uniformat e punës (dimrore dhe verore si dhe fitimin e parashikuar të OE.

OE janë të obliguar të paraqesin analizen finaciare duke përfshir të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

-Oferta duhet të këtë të kalkuluar edhe çminin lidhur me uniformat e punës (dimrore dhe verore si dhe fitimin e parashikuar të OE.

OE janë të obliguar të paraqesin analizen finaciare duke përfshir të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Kompania fituese duhet te sjell deshmi se ka 100 puntorë..(licence valide)

Ofertuesi duhet te siguroj përsonele të mjaftueshëm për mirëmbajtje të objekteve gjatë 24 orëve dhe duhet të organizoj punën në atë menyrë që shërbimet e kërkuara të realizohen pa ndërprere.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Derivimi i lejuar nga sasia totale indikative është ±30%.

Lokacionet dhe pikat ku do të vendosën rojet	Orë shërbimi gjatë ditës	Ditë sigurimi gjatë javës	Orë shërbimi gjate javës
Prishtinë-Universiteti Prishtines - Hasan Prishtina			
Rektorati	24	7	168
Rektorati(Roja ditën)	9	5	45
Rojet levisese neper hapesirat e UP-se	96	7	672
Fakulteti I Mjekësisë	72	7	504
Fakulteti I Mjekësisë (Parkingu)	9	5	45
Fakulteti Makinerisë dhe Ndërtimtarisë	24	7	168
Fakulteti Teknik	48	7	336
Fakulteti I SHMN.(Kimi,Biologji dhe Administratë)	72	7	504
Fakulteti Filozofik	24	7	168
Fakulteti Filologjik	24	7	168
Fakulteti I Arkitektures	24	7	168
Fakulteti Ekonomik/Juridik	48	7	336
Fakulteti I Edukimit	48	7	336
Fakulteti I Arteve	48	7	336
Fakulteti I Arteve	8	5	40
Fakulteti I Bujqësisë (Objekti i vjetër)	48	7	336
Fakulteti I Kulturës Fizike	24	7	168
Parkingi te Fakulteti Ekonomik/Juridik	11	6	66
Rampa te Fakulteti Filologjik	12	5	60
Administrata Qendrore	8	5	40
Bibloteka Universitare	24	7	128
Bibloteka Universitare Recepcioni	8	5	40
Fakulteti i Arteve Muzika	24	7	128
Fakulteti i Bujqësisë objekti i ri	48	7	336
Fakulteti i Bujqësisë objekti i ri(Roja ditën)	18	5	90
Fakulteti i Mjekësisë objekti i ri	48	7	336
Gjithsejt për UP	795	129	5722

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Derivimi i lejuar nga sasia totale indikative është ±30%.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

3.5 OE ne rast se nuk ju permbahet specifikimit teknik dhe pershkrimit te qmimit atëher AK do ti merr te gjitha masat ndeshkueses ndaj OE per mos permbushje te kontrates.

3.6 AK është e obliguar që të gjitha Obligimet ndaj OE ti kryej me kohë dhe at mëse largu nga 28 të muajit të shkuar dhe 5 të muajit të ardhshëm.

3.7 OE është i obliguar ti mbajë ne burime dhe të paguaj kontributet dhe tatimet për puntor në bazë të Legjislacionit Tatimor në Kosovë, po ashtu pagesa e pagave për çdo puntor do të bëhet në xhironlogari të puntorit dhe atë më së largu 5 ditë të muajit pasuese, çdo ditë vones të pagesës së pagave pas ditës së 5 do të llogaritet si pengjegjesi e OE.

Neni 4

Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5

Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	Selma Qorri
Pozita:	Zyrtarë përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	01.04.2021
Vula:	

Ne rast të kontratave me vlerë të madhe

Emri:	Ma. Sc. Esat Kelmendi	Emri:	Prof. dr. Naser Sahit
Pozita:	Sekretar i Përgjithshëm i UP-së	Pozita:	Rektor i Universitetit të Prishtinës - Hasan Prishtina
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.04.2021	Data:	01.04.2021

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Kushtrim Krasniqi
Pozita:	Drejtor i Kompanisë
Nënshkrimi:	
Data:	01.04.2021
Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjë arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokatat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimin për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

- OE është i obliguar ti mbaj në burime dhe të paguaj kontributet dhe tatimet për puntorë në bazë të Legjislacionit Tatimor në Kosovë, po ashtu pagesa e pagave për çdo puntor do të bëhet në xhirollogari të puntorit dhe atë me së largu deri në ditën e pestë (5) të muajit pasuese. Çdo ditë voneses të pagesës së pagave pas ditës së pestë (5), do të llogaritet si përgjegjësi e OE dhe do të evidentohet në performancën e OE.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shfrytëzojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

- AK gjat performances së kryerjes së shërbimeve nese vëren se nuk janë duke u kryer shërbimet si duhet, me një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar mir, mund të kërkojë një zëvendësim nëse e vleron se një nga stafi i OE është i pa përgjegjshëm gjat kryerjes së detyrave të tij gjatë orarit të punës.
- Po ashtu edhe OE nëse vendos të zëvendësojë stafin për të cilin mendon se është i pa aftë, apo i pa përgjegjshëm duhet ti ofroj AK dëshmi se janë shqiptuar te pakten 3 vërejtje ndaj Puntorit.
- Për çdo zëvendësim të stafit, OE është i obliguar që të plotësojë një Deklaratë për konfidencialitetin para fillimit të punës. Kjo deklaratë duhet të dorëzohet tek Menaxheri i Kontrates nga ana e AK-së.

- OE për të gjitha pikat nën përgjegjesin e stafit të kompanis, mban përgjegjësi për gjdo vjedhje apo devijim nga detyrat dhe përgjegjesit e stafit te tij.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “*Menaxherin e Projektit*”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

12.4 Menaxheri i Projektit do të caktohet pas lidhjes së kontratës. Te gjitha raportet e Njësive kërkuese, duhet te dorzohen me se largu dy ditët e fundit te muajit te cilit jan kryer shërbimet.

Raportet duhet të jen të nënshkruara dhe të protokollar, pastaj dorëzohen për pagës bashkangjitur faturën e OE, dhe Raportin e Menaxherit te kontratës.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe ne këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;

- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, të furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që

zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes së kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë së sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asemi të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

1. PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit do të caktohet pas lidhjes së kontratës. Te gjitha raportet e Njësive kërkuese, duhet të dorzohen me se largu dy ditët e fundit të muajit të cilit janë kryer shërbimet. Raportet duhet të jenë të nënshkruara dhe të protokolluar pastaj dorzohen për pagë të bashku me faturën e OE dhe Raportin e Menaxherit të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10 % e vlerës së kontratës, për 37 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë b) Përgjegjësia e palës së tretë c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve d) Përgjegjësia profesionale e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve <i>Të gjitha kompensohen në bazë të parashikimit të ligjeve në fuqi.</i>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Perioda e përgjegjësisë së OE është gjdo vjedhje apo keq menaxhim i punës ndaj AK si dhe ndaj stafit të tij.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Përgjegjësi e zgjidhjes miqësore e mosmarrëveshjes është Departamenti i Prokurimit në koordinim me Menaxherin e Kontrates dhe Mbikqyresin</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

Lënda: Deklaratë

Refefuar tenderit me numër prokurimi: 242-20-1251-2-1-1

Deklaratë

Kompania e sigurimit fizik dhe elektronik "Rojet e Nderit" sh.p.k me numër të biznesit 810519209, me Selin Qendore në Prishtinë Lagjija Arbëri/Dradogan Rr." Gjergj Balshaj" pn. Deklaron për Universitetin e Prishtinës, Kompania e Sigurimit Fizik "Rojet e Nderit", është pajtuar në përgjithësi me kërkesat në dosjen e tenderit me titull: " Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës"

Me këtë deklaratë deklarojm dhe garantojm se jemi në pajtueshmëri me kërkesat dhe specifikat e Aneks I dhe do respektojm të gjitha kërkesat dhe vërejtjet e cekura në Aneks1.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

- Te ofrohet shërbimi i sigurimit fizik per objektet dhe hapsiren e Universitetit te Prishtines, 24 ore ne dite 7 dite te javes, vendosjen dhe monitorimin e sistemeve te mbikëqyrjes elektronike, roje statike per kontroll te hyrje-daljes se njerëzve, automjeteve dhe artikujve, patrullime përreth objekteve te UP-se, gjate dhe jashte oreve te punes, per te siguruar perimetrin e objekteve dhe hapësirave te UP-se.
- Operatori Ekonomik duhet te jete ne gjendje te kryej shërbime, duke zbatuar profesioalizem, efikasitet dhe fleksibilitet te shërbimeve.
- Operatori Ekonomik duhet te mirëmbaj ato ekzistuese dhe te implementoj zgjidhje te reja per sigurine fizike dhe teknike
- Operatori Ekonomik duhet te garantoj se personeli i tyre do te kryejne shërbime ne përputhje me përcaktimet e kontrates, ne interesin me te mire te UP-se, personelit dhe studenteve. Ne te njejten kohe, Operatori Ekonomik duhet te garantoj te gjitha ndërtesat, hapësirat dhe te mirat materiale te Up-se do te jene te sigurta dhe te mbrojtura nga vjedhja, demtimi, zjarri apo rreziqet tjera.

VERETËJE:

Kompania që të vlersohet e pergjegjeshme është e obliguar që të respektoj pagën bazë mujore minimale në shum prej 280 € bruto, duhet te parashihet shtesë për pagës sipas ligjit të punës: orë për punë gjatë



ditëve të festave, orë për punë gjatë natës, orë për punë gjatë fundjavës, orë për punë gjatë pushimit vjetor.

Oferta duhet të ketë të kalkuluar edhe çminin lidhur me uniformat e punës (dimrore dhe verore si dhe fitimin e parashikuar të OE.

OE janë të obliguar të paraqesin analizen financiare duke përfshir të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

-Oferta duhet të ketë të kalkuluar edhe çminin lidhur me uniformat e punës (dimrore dhe verore si dhe fitimin e parashikuar të OE.

OE janë të obliguar të paraqesin analizen financiare duke përfshir të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Kompania fituese duhet të sjell deshmi se ka 100 puntorë, (licence valide)

Ofertuesi duhet të siguroj personel të mjaftueshëm për mirëmbajtje të objekteve gjatë 24 orëve dhe duhet të organizoj punën në atë menyrë që shërbimet e kërkuara të realizohen pa ndërprere.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Derivimi i lejuar nga sasia totale indikative është $\pm 30\%$.

Lokacionet dhe pikat ku do të vendosën rojet	Orë shërbimi gjatë ditës	Ditë sigurimi gjatë javës	Orë shërbimi gjate javës
Prishtinë			
Rektorati	24	7	168
Rektorati(Roja ditën)	9	5	45
Rojet levisese neper hapesirat e UP-se	96	7	672
Fakulteti I Mjekësisë	72	7	504
Fakulteti I Mjekësisë (Parkingu)	9	5	45
Fakulteti Makinerisë dhe Ndërtimtarisë	24	7	168
Fakulteti Teknik	48	7	336
Fakulteti I SHMN.(Kimi,Biologji dhe Administratë)	72	7	504
Fakulteti Filozofik	24	7	168
Fakulteti Filologjik	24	7	168
Fakulteti I Arkitektures	24	7	168
Fakulteti Ekonomik/Juridik	48	7	336
Fakulteti I Edukimit	48	7	336
Fakulteti I Arteve	48	7	336
Fakulteti I Arteve	8	5	40
Fakulteti I Bujqësisë (Objekti I vjetër)	48	7	336
Fakulteti I Kulturës Fizike	24	7	168
Parkingj te Fakulteti Ekonomik/Juridik	11	6	66
Rampa te Fakulteti Filologjik	12	5	60
Administrata Qendrore	8	5	40



Biblioteka Universitare	24	7	128
Biblioteka Universitare Recepcioni	8	5	40
Fakulteti i Arteve Muzika	24	7	128
			336
Fakulteti i Bujqësisë objekti i ri	48	7	
Fakulteti i Bujqësisë objekti i ri(Roja ditën)	18	5	90
Fakulteti i Mjekësisë objekti i ri	48	7	336
Gjithsejt për UP	795	129	5722

Sasia e parashikuar është vetëm sasi indikative. Derivimi i lejuar nga sasia totale indikative është ±30%.





Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: "ROJET E NDERIT" SHPK deklaroj nën betim se jam i përshatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtëseish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	"ROJET E NDERIT" SHPK
Adresa e plotë:	PRISHTINE
I përfaqësuar nga:	
Emri	KUSHTRIM KRASNIQI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	23.07.2020
Vula	

ANALIZA FINANCIARE

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	Totali i kostomesatave e shpërndarë për njëpunëtor	Totali për 12 muaj për njëpunëtor	Totali për 36 muaj për njëpunëtor
1	Pagabruco	280.00	3,360.00	10,080.00
2	Oret e natës 30%	20.24	242.88	728.64
3	Oret e festave 50%	4.60	55.20	165.60
4	Oret e vikendeve 50%	39.87	478.44	1,435.32
5	Pushimivjetor mesatare në muaj	21.21	254.52	763.56
6	Gjithsejt pagabruco, orë natës, festa, vikende, pushimivjetor (1+2+3+4+5)	365.92	4,391.04	13,173.12
7	Trusti pensional 5% i punëdhënësit	18.30	219.55	658.66
8	Uniforma Dimrore	0.33	3.96	11.88
9	Uniforma Verore	0.20	2.40	7.20
10	Fitimi i Kompanisë për njëpunëtor në muaj	0.05	0.60	1.80
11	Gjithësejt kostojat për punëtor (6+7+8+9+10) pa tvsh	384.80	4,617.55	13,852.66
12	18% TVSH-ja	69.26	831.16	2,493.48
13	Gjithësejt kostojat për punëtor (11+12) me tvsh	454.06	5,448.71	16,346.13
14	Cmimi pa Tvsh për një orë punë për njëpunëtor për 176 orë pune (U.A.D. (MPMS) Nr. 09/2017)	2.19	2.19	2.19
15	18% TVSH-ja	0.39	0.39	0.39
16	Cmimi me Tvsh për një orë pune	2.58	2.58	2.58

Nr	Përshkrimi	Oret Totale për 36 muaj	Cmimi për orë me tvsh	Totali për 36 Muaj
1	"Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës"	823,968.00	2.58	2,125,837.44



Të nderuar konfrom kërkeses tuaj ne në analizen financiare kemi kalkuluar të gjitha kërkesat e cekura nga ju si më poshtë:

Kompania që të vlersohet e pergjegjeshme është e obliguar që të respektoj pagën bazë mujore minimale në shum prej 280 € bruto,duhet te parashihet shtesë për pagës sipas ligjit të punës

- orë për punë gjatë ditëve të festave,
- orë për punë gjatë natës,
- orë për punë gjatë fundjavës ,
- orë për punë gjatë pushimit vjetor
- Oferta duhet të këtë të kalkuluar edhe çmimin lidhur me uniformat e punës (dimrore dhe verore si dhe fitimin e parashikuar të OE.



Përshkrimi i çmimit

PJESA<Nr>							
NR. I ART.	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATESE	SASIA	ÇMIMI PËR PA TVSH €	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJ ME TVSH €	ÇMIMI TOTA ME TVSH €
1	"Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit Prishtinës"	ORE	823968	2.19	18%	2.58	2,125,837.44
TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TE GJITHA TAKSAT E APLIKUESHME NE KOSOVE DUKE PËRFSHIRE EDHE TVSH SI DHE PAGAT E PUNTOREVE, UNIFORMAT, DHE TE TJERA SIPAS ANALIZES FINANCIARE:							2,125,837.44

*Ofertuesi duhet të siguroj personel të mjaftueshëm për mirëmbajtje të objekteve gjatë 24 orëve dhe duhet të organizoj punën në atë mënyrë që shërbimet e kërkuara të realizohen pa ndërprerje.
Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Derivimi i lejuar nga sasia totale indikative është +30%.*

Verejtje: OE duhet të paraqesë analizë financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analizë duhet të përfshijë:

- Pagat bruto perpunorë me të gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH.
- Vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit në dosjen e tenderit.
- Pushimet vjetore, ndrrimet e natës, festat shtetërore
- Fitimi i parashikuar nga O.E.





Për: Universitetin e Prishtinës

Lënda: Deklaratë

Refefuar tenderit me numër prokurimi: 242-20-1261-2-1-1

Deklaratë

Kompania e sigurimit fizik dhe elektronik "Rojet e Nderit" sh.p.k me numër të biznesit 810619209, me Selin Qendore në Prishtinë Lagjija Arbëri/Dradogan Rr." Gjergj Balshaj" pn. Deklaron për Universitetin e Prishtinës, Kompania e Sigurimit Fizik "Rojet e Nderit", është pajtuar në përgjithësi me kërkesat në dosjen e tenderit me titull: " Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës"

Deklarojm se konform kërkesave tuj caktojm menaxher të Projektit Z. Fidan Mjeku i cili ka përvoj shumëvjeqare në Fushën e Sigurisë dhe diplomë Universitare.





Për:Universitetin e Prishtinës

Lënda: Deklaratë

Refefuar tenderit me numër prokurimi: 242-20-1251-2-1-1

Deklaratë

Kompania e sigurimit fizik dhe elektronik "Rojet e Nderit" sh.p.k me numër të bizesit 810619209, me Selin Qendore në Prishtinë Lagjija Arbëri/Dradogan Rr." Gjergj Balshaj" pn. Deklaron për Universitetin e Prishtinës, Kompania e Sigurimit Fizik "Rojet e Nderit", është pajtuar në përgjithësi me kërkesat në dosjen e tenderit me titull: " Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës"

Të nderuar

Lidhur me kërkesen tuaj ku keni kërkuar që

Oferta duhet të këtë të kalkuluar edhe çmimin lidhur me uniformat e punës (dimrore dhe verore si dhe fitimin e parashikuar të OE.

Ne kemi vendosur çmimë simbolik pasi që kemi Rezerva të mjaftueshme dhe për të cilat kemi kryer edhe obligimet.

Provë vertetimi i bashkangjitur i furnizuesit me uniforma.



Nga: "Arta Tex Group" sh.p.k

08.06.2020

Për: "Rojet e Nderit" Shpk

Lënda: Vërtetim

Refuzim Kërkesës për konfirmim të stokut/rezervave.

Kompania e Prodhimit të uniformave Nga: "Arta Tex Group" sh.p.k duke u bazuar në kërkesen e Kompanisë "Rojet e Nderit" sh.p.k me numër të biznesit 810519209, me Selin Qendore në Prishtinë Lagjija Arbëri/Dradogan Rr." Gjergj Balshaj" pn. Deklaron se Klienti i lartë cekur ka marrëveshje për furnizim në me uniforma pune për punëtor dhe duke u bazuar në gjendjen që kemi rezerva të krijuara nga kjo kompani ne deklarojmë se Kompania e Sigurimit Fizik "Rojet e Nderit", ka të deponuar sasisë të uniformave për të cilat ka kryer edhe obligimet si në tabelën e më poshtme:

UNIFORMA VERORE		
Nr	Përshkrimi	Sasia
1	Pantollona verorë	1500 copë
2	Maica verore	1500 copë
3	Emblema	1500 copë

UNIFORMA DIMËRORE		
Nr	Përshkrimi	Sasia
1	Pantollona dimëror	1500 copë
2	Këmisha	1500 copë
3	Jakëne Dimërore	1500 copë
4	Emblema	1500 copë
5	Kravata	1500 copë

Deklarojm se për produktet e lartëcekura janë të kryera obligimet dhe menjëherë pas kërkeses ne do i dorëzojm tek klienti.

Me respekt:

